

DEGA: GAZETARI

PROGRAMI I STUDIMEVE: BA

SILABUSET E LËNDËVE: MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Marrëdhënie me Publikun
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	viti i III-të, semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	8
Koha / Vendi:	Ligjerata (salla 101): e enjte 16- 17:30 Ushtrime (salla 101): e premte 9-10:30 Gr. I 10:30-12 Gr.II
Mësimdhënësi: Asistenti/ja:	Prof. ass. Remzie Shahini-Hoxhaj, PhD Ass. Dren Gërguri, PhD
Të dhënat kontaktuese:	remzie.shahinihoxhaj@uni-pr.edu dren.gerguri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë ofron një hyrje në e marrëdhënieve me publikun (e njohur si Public Relations-PR), një industri që po zhvillohet me një hov të madh kohëve të fundit. Marrëdhëniet me publikun nënkuptojnë procesin e njohjes së klientëve, të publikut nevojave, emergjencave dhe zgjidhjes së tyre. Kjo lëndë poashtu ju ofron njohuri për një aspekt shumë të rëndësishëm të marrëdhënieve me publikun atë të komunikimit në sferën publike. Është dizajnuar në atë mënyrë që t'ju pajisë me pjesën teorike dhe praktike të komunikimit në sferën publike. Në këtë lëndë përveq konceptit për publikun, sferën publike do të diskutohet edhe për diskursin dhe format e komunikimit në këtë sferë. Studentet do të mësojnë për rendesine e komunikimit personal dhe profesional, në grup dhe publik. Do të njihen me strategji për tejkalimin e frikës gjatë ligjerimit dhe të prezantimit të fjalime profesionale. Si të hulumtojnë audiencën dhe si të ju përshtaten kushteve të ndryshme socio-kulturore. Poashtu do të njihen me metodat e krijimit të opinionit publik dhe përdorimit të mekanizmave bindës e komunikimit në

	sferen publike.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë do të ju shërbejë studentëve të ndërtojnë, ngritin dhe testojnë vlerat e tyre në sferën e komunikimit publik. Poashtu të stimuloj mendimin kritik me qëllim të përpunimit, sajimit dhe diskutimit të fjalimeve të ndryshme të shkuara apo të folura. Në fund të këtij kursi studentët duhet të jenë gjendje ta njohin audiencën që i drejtohen.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët duhet të kenë njohuri gjithë aspektin e komunikimit në kuadër të marrëdhënieve me publikun si në kontekstin individual poashtu edhe të organizatave. Poashtu ata duhet të jenë gjendje t'i aplikojnë këto njohuri edhe në praktik.
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	1	15	15
Punë praktike	2	15	30
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren	2	15	30
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	5	2	10
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			184,5 orë

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata do të ndahen në pjesën e ligjërimit, referateve të shkurta dhe pjesë së diskutimit. Studentët do të ftohen mbledhin njohuri nga literatura shtesë për secilën njësi mësimore dhe të prezatojnë dhe shkruajnë një fjalim për çfarëdo teme që ata kanë dëshirë.
Metodat e vlerësimit:	20% Pjesëmarrja aktive në ushtrime 30% Fjalimi (prezantimi dhe shkrimi i tij) 30% Kampanja (prezantimi dhe skema e komunikimit) 20% Provim i fundit
Literatura primare:	Lucas, Stephen E. (2010): Arti i te folurit publik. Tiranë. UET Press Marconi, Joe (2010): Marrëdhëniet me publik. UET Press, Tiranë Lamerton, Lucas (2004): Complete Guide Public Speaking. Speak in Public with Confidence. Glasgow: Haper Collins Publisher Salter, Colin (2021): 100 fjalimet që ndryshuan botën. New York. Rizzoli Universe Promotional Books.
Literatura shtesë:	Neza, Agim (2004): <i>Marrëdhënie Publike</i> . Instituti Shqiptar i Medias. Tiranë. Fraser P. Seitel. (2001): <i>The Practice of Public Relations</i> , 8th ed. Prentice Hall. Foster, John (2005): Effective writing skills for Public Relations. 3 rd Edition. CIPR. Kogan Page. London and Philadelphia. McNair, Brain (2000): <i>An introduction to Political Communication</i> . 2 nd Edition. London. Taylor & Francis Group. Wilcox, Dennis (2005): <i>Public Relations Writing And Media Techniques</i> (5 th ed.). Wilcox, D. L., Cameron, G. T., Ault, P. H., & Agee, W. K. (2000): <i>Public relations: Strategies and tactics</i> (7th ed.). New York: Longman. Witmer, Diane F. (2000): <i>Spinning the Web: A Handbook for Public Relations on the Internet</i> . Longman. New York.

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java 1:	Prezantimi i lëndës
Java 2:	Komunikimi në sferën publike dhe arti i të folurit publik
Java 3:	Opinion i publik
Java 4:	Koncepti fillestar
Java 5:	Planifikimi i një ligjërata/ referati/ prezantimi
Java 6:	Tejkalimi i frikës dhe analiza e audiencës

Java 7:	Prezantimet e fjalimeve
Java 8:	Prezantimet e fjalimeve
Java 9:	Hapat dhe mjete e MP
Java 10:	Krijimi i portfolios personale dhe institucionale
Java 11:	Konferencat, konferncat për shtyp dhe komunikikatat për media
Java 12:	Intervistat e punës dhe intervistat tjera
Java 13:	Roli i PR-it në ekonomi dhe në politikë
Java 14:	Prezantimi i kampanjave
Java 15:	Prezantimi i kampanjave

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- ✓ Studentët duhet të jenë me kohë në klasë, rregull që vlen edhe për mësimin online.
- ✓ Studentët duhet ta vijojnë rregullisht modulën. Më shumë se tri mungesa ndikojnë në notën përfundimtare dhe duhet shqyrtuar pjesëmarrja juaj në provimin përfundimtar
- ✓ Studentët duhet të jenë social dhe ti sfidojnë kolegët dhe anasjelltas, në suaza të sjelljeve demokratike të një debati.
- ✓ Studentët duhet ti dorëzojnë detyrat me kohë. **Punimet e vonuara nuk do të merren parasysh!**
- ✓ Studentët duhet ti mbajnë telefonat e çkyçur (fikur) gjatë orëve të mësimin, ndërsa gjatë orëve online kamerat e ndezura!

Kopjimi dhe plagjiatura : Studentët të cilët në punimet e tyre kopjojnë apo bëjnë plagjiaturë do të raportohen në organet udhëheqëse të Universitetit!